

MBI NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

për periudhën janar-mars 2003

1. Ndërhyrjet në tregun e parasë


1.1. Operacionet e tregut të hapur

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2003, situata e likuiditetit në sistemin bankar ka ndryshuar nga mungesë likuiditeti në tepriçë likuiditeti. Tregu u karakterizua me mungesë likuiditeti deri në fund të muajit janar por, Banka e Shqipërisë ndërhyri me marrëveshjet e anasjellta të riblerjes të tipit me çmim fiks (8.50%) dhe me shumë të pashpallur, deri në fillim të muajit mars. Veçojmë se katër nga ankandet e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes nuk u organizuan për shkak të mosparaqitjes së kërkesave nga ana e bankave të nivelit të dytë. Vendimi për vazhdimin e ndërhyrjeve me Reverse-REPO(marrëveshjet e anasjellta të riblerjes) edhe kur tregu nuk paraqitej me mungesë likuiditeti, kishte për qëllim lënien e likuiditeteve të lira në treg me synimin rritjen e presionit për uljen e *yeild-it* të bonove të thesarit.

Ndërhyrjet për thithjen e likuiditetit të tepërt u bënë javën e tretë të muajit mars nëpërmjet organizimit të ankandeve të marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor dhe njëmuajor. Ankandi i marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor ishte me çmim fiks (8.50 për qind) dhe me shumë të pashpallur. Tërheqja e likuiditeteve nëpërmjet këtyre ankandeve rezultoi në nivelin 465 milionë lekë mesatarisht për ankand. Ndërsa ankandi i marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëmuajor ishte me shumë çmime dhe me shumë të shpallur 3 miliardë lekë. Tërheqja e likuiditetit nëpërmjet këtij instrumenti rezultoi në shumën 2,4 miliardë lekë dhe interes 10.11 për qind.


Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin volumin e ndërhyrjeve në tregun e parasë:

Data	R/REPO	
	javore	REPO mujore
06-Jan-03	3,040.00	
09-Jan-03	2,530.00	
16-Jan-03	1,810.00	
23-Jan-03	1,795.00	
30-Jan-03	1,325.00	
06-Feb-03		
13-Feb-03	30.00	
20-Feb-03		
27-Feb-03		
06-Mar-03	400.00	
13-Mar-03		
20-Mar-03		350.00
27-Mar-03		580.00
		2,400.00



1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse.

Në mbështetje të instrumentit kryesor të tregut, bankat kanë përdorur gjerësisht depozitën njëditore për investimin e likuiditeteve të lira, niveli i së cilës erdhi në ulje me ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes. Përdorimi i depozitës njëditore ishte në nivelin mesatar ditor prej 2 miliardë e 256 milionë lekësh, ndërsa kredia njëditore ishte në nivel të ulët përdorimi mesatarisht, 43 milionë lekë në ditë.



Ndërrhyrja aktive

2. Ndërhyrjet në tregun e brendshëm valutor

Gjatë periudhës janar–mars 2003 operacionet e ndërhyrjes aktive janë orientuar drejt blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë, me synim ndikimin e kursit të këmbimit nëpërmjet pakësimit të ofertës në valutë në tregun e brendshëm valutor. Vërehet se në operacionet e kryera me këto banka, monedha amerikane (Usd) përbën zërin kryesor të blerjeve. Në total të vëllimit të blerjeve në masën 28,337.74 mijë usd, vetëm 104.74 mijë usd përfaqësojnë veprime në monedhën e përbashkët evropiane (Eur).